



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

**STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL
TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI (TIK)**

Niveli II në KSHK¹, referuar niveli II të KEK²

T-II-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja	4
Niveli	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Data e validimit	5
Data e miratimit	5
Variantet e mëparshme	5
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL	6
NjN-19-II-0325-25 Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-19-II-0326-25 Instalimi i pajisjeve hardware	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-19-II-0327-25 Instalimet e rrjetit	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	9
Kriteret e Vlerësimit	9
NjN-19-II-0328-25 Mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të pajisjeve hardware	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-19-II-0329-25 Instalimi dhe mirëmbajtja e programeve (software-ve)	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-19-II-0330-25 Mbështetja e përdoruesit	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-19-II-0331-25 Siguria e të dhënave	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-19-II-0332-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14

Kriteret e vlerësimit	14
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse	14
Modalitetet e vlerësimit.....	15
Informacion shtesë	15
SHËNIM.....	15

Emërtimi i kualifikimit	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)			Kodi T-II-25
Kohëzgjatja	3000 orë nocionale	Niveli	Niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre në nivelin ndihmës për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe suplementin përkatës të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në rolin e ndihmësit në TIK në njësitë e tregtimit dhe shërbimit të pajisjeve kompjuterike, si dhe pranë institucioneve apo bizneseve që realizojnë riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe programeve kompjuterike, rrjeteve të komunikimit, si dhe në veprimtari të tjera që lidhen me to.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV, në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, në një nga kualifikimet profesionale (dyvjeçare), duke fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Ofruesit	<p>Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.</p>			

Data e validimit	Maj 2025
Data e miratimit	
Variantet e mëparshme	T-I-15; T-II-19

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional **“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” niveli II në KSHK**, referuar nivelit II të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënimit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënimit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe t'i shpërndajë ato, në dobi të kolegëve e punonjësve në njësisë e tij/saj prodhuese;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të ndër marrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
9. Të demonstrojë maturi me eprorët;
10. Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij/saj, si dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
11. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
12. Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë aftësitë e tij/saj, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
13. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
14. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
15. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;

16. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
17. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
18. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
19. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
20. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-19-II-0325-25 Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit bazë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
2. Të përshkruajë sektorin dhe tendencat e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
3. Të shpjegojë mënyrën e organizimit ergonomik të vendit të punës;
4. Të përshkruajë pozicionet e punës (organigrama) së një institucioni/biznesi;
5. Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të nevojave teknike;
6. Të përshkruajë hapat e proceseve të punës për zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e detyrave, sipas prioriteteve;
7. Të përshkruajë llojet e mjeteve, materialet dhe pajisjet e punës, funksioni dhe përdorimi i tyre;
8. Të përshkruajë rëndësinë e interpretimit të manualeve të pajisjeve të punës;
9. Të përshkruajë rëndësinë e caktimit të prioriteteve në listën e detyrave;
10. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e bashkëpunimit me kolegë/specialistë të tjerë;
11. Të listojë teknologjitë ndihmëse në organizimin e punës;
12. Të listojë llojet e dokumentacioneve teknike;
13. Të përshkruajë mënyrat e dokumentimit dhe raportimit të punës;
14. Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;
15. Të përshkruajë llojet e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, sipas karakteristikave dhe përdorimit të tyre;
16. Të përshkruajë metodat e komunikimit efektiv;
17. Të shpjegojë parimet e punës në grup;
18. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
19. Të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit të performancës personale;
20. Të përshkruajë mënyrat e zhvillimit profesional;
21. Të listojë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në TIK;

22. Të klasifikojë llojet e trajnimeve dhe kurseve teknike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë planifikimin dhe përzgjedhjen e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
2. Të dokumentojë punën sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi;
3. Të zbatojë rregullat e komunikimit me kolegë/eporë/specialistë të tjerë;
4. Të ndjek trajnime për zhvillimin profesional.

Kriteret e vlerësimit

- Respekton legjislacionin bazë të fushës së TIK;
- Merr detyrën sipas udhëzimeve;
- Zbaton detyrat sipas projektit;
- Planifikon saktë radhën e punës;
- Planifikon mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas projektit;
- Përdor mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas proceseve;
- Kontrollon funksionimin dhe gatishmërinë e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas udhëzimeve;
- Bashkëpunon në mënyrë efektive me kolegë/eporë/specialistë të tjerë duke zbatuar rregullat në komunikim;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Kryen mirëmbajtjen dhe sistemimin e vendit të punës periodikisht;
- Dokumenton proceset e punës së kryer sipas formateve;
- Raporton periodikisht tek eprori për punën e kryer;
- Informohet mbi të rejat dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Zbaton parimet e punës në grup;
- Zbaton teknologjitë e reja të komunikimit;
- Përdor saktë terminologji profesionale;
- Komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera;
- Ndjek trajnime për zhvillim të vazhduar profesional.

NjN-19-II-0326-25 Instalimi i pajisjeve hardware

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë pajisjet kompjuterike dhe komponentët e tyre;
2. Të përshkruajë funksionin e komponentëve bazë të një kompjuteri;
3. Të listojë pajisjet e rrjetit;
4. Të shpjegojë sistemet e shfrytëzimit, tipet dhe funksionet e tyre;
5. Të përshkruajë mënyrat e instalimit të pajisjeve kompjuterike, periferike dhe të rrjetit;

6. Të përshkruajë konfigurimet e thjeshta të pajisjeve;
7. Të shpjegojë metodat e kontrollit të instalimeve të kryera;
8. Të dallojë parametrat nominalë të pajisjeve;
9. Të listojë llojet e pajisjeve testuese sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
10. Të dallojë ndërfaqet e jashtme të pajisjeve periferike, portat dhe karakteristikat e tyre;
11. Të përshkruajë qëllimin, funksionin dhe mënyrën e instalimit të driver-it.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

12. Të zbatojë procedurat standarde për montimin e pajisjeve informatike dhe komponentëve të tyre;
13. Të kryejë instalimet dhe konfigurimet e pajisjeve informatike;
14. Të kryejë kontrollin për instalimet dhe konfigurimet e kryera.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton procedurat standarde për montimin e pajisjeve kompjuterike dhe komponentëve të tyre;
- Klasifikon komponentët bazë të një kompjuteri sipas funksionit;
- Instalon pajisjet kompjuterike dhe të rrjetit sipas udhëzimeve teknike;
- Respekton masat e sigurisë gjatë instalimit të pajisjeve kompjuterike dhe rrjetit;
- Kryen konfigurime të thjeshta të pajisjeve, sipas manualit;
- Përdor pajisjet testuese sipas funksionit të tyre;
- Kontrollon instalimet e kryera, sipas procedurave standarde;
- Krahason parametrat e pajisjeve me parametrat nominalë;
- Kryen instalimet e driver-it, sipas manualit;
- Dokumenton saktë instalimet dhe konfigurimet e kryera.

NjN-19-II-0327-25 Instalimet e rrjetit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë elementët kryesorë të planimetrisë së një rrjeti dhe rolin e tyre;
2. Të identifikojë lidhjet dhe komponentët e rrjetit;
3. Të listojë instrumentet matëse si: multimetra, tester-a kabllorsh dhe analizues të rrjetit, funksionin dhe përdorimin e tyre;
4. Të shpjegojë mënyrën se si kryhen matjet bazë për instalimet;
5. Të përshkruajë rrjetin në bazë të topologjisë së përcaktuar në planimetri;
6. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e instalimit të kabllorëve sipas standardeve të industrisë për rrjete;
7. Të shpjegojë radhën e punës për shtrimin e kabllorëve;
8. Të përshkruajë rëndësinë e etiketimit të kabllorëve për të siguruar një rrjet të organizuar;
9. Të përshkruajë llojet kryesore të nyjeve fundore dhe konektorëve;
10. Të listojë hapat bazë për instalimin e nyjeve fundore dhe konektorëve;
11. Të listojë mjetet dhe pajisjet bazë që përdoren për testimin e lidhjeve të rrjetit dhe

- komunikimit;
12. Të shpjegojë rëndësinë e testimit të rrjetit dhe komunikimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kabllimin, instalimin dhe konfigurimin e rrjetit;
2. Të kryejë kontrollin e rrjetit;
3. Të dokumentojë instalimet e kryera.

Kriteret e Vlerësimit

- Evidenton saktë elementët kryesorë të planimetrisë së rrjetit;
- Analizon rolin e secilit element në rrjet;
- Interpreton skicat e rrjetit pa gabime;
- Evidenton tipin e rrjetit bazuar në topologjinë e tij;
- Përdor saktë instrumentet matëse si: multimetra, testues kabllosh dhe analizues rrjeti;
- Zbaton radhën e punës për shtrimin e kabllave në rrjet;
- Instalon kabllot sipas standardeve të industrisë;
- Kryen matje bazë për të verifikuar cilësinë e instalimeve;
- Kryen saktë organizimin dhe etiketimin e kabllave sipas skemës;
- Dokumenton saktë organizimin e kabllave;
- Zbaton hapat për instalimin e nyjeve fundore dhe konektorëve;
- Kontrollon funksionalitetin e lidhjeve në rrjet;
- Teston rrjetin, sipas standardit.

NjN-19-II-0328-25 Mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të pajisjeve hardware

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes së pajisjeve kompjuterike;
2. Të rendisë hapat për kontrollin vizual të pajisjeve;
3. Të klasifikojë programet aplikative të monitorimit sipas llojit dhe përdorimi i tyre;
4. Të listojë llojet e defekteve në pajisje;
5. Të përshkruajë metodat e identifikimit të defekteve të zakonshme hardware;
6. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të procedurave të riparimeve të thjeshta;
7. Të përshkruajë rëndësinë e mbrojtjes nga elektriciteti statik gjatë punës me pajisjet hardware;
8. Të rendisë hapat për zëvendësimin e komponentëve të dëmtuar në pajisjet kompjuterike;
9. Të shpjegojë mënyrat e testimit të pajisjeve pas riparimit/zëvendësimit;
10. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të planit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardware;
11. Të përshkruajë mënyrat e regjistrimit dhe raportimit të mirëmbajtjes së kryer;
12. Të përshkruajë teknikat e pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm të pajisjeve;
13. Të përshkruajë kontrollet periodike për të siguruar funksionimin e rregullt të pajisjeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë identifikimin e defekteve të thjeshta;
2. Të zbatojë procedurat e mirëmbajtjes/riparimit/zëvendësimit të pajisjeve kompjuterike;
3. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin e mirëmbajtjes/riparimit/zëvendësimit të kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton manualin e mirëmbajtjes;
- Zbaton procedurat e mirëmbajtjes së pajisjeve kompjuterike;
- Zbaton hapat për kontrollin vizual të pajisjeve;
- Përdor programet aplikative të monitorimit sipas udhëzimeve;
- Identifikon saktë defektet në pajisje të thjeshta hardware;
- Kryen riparime të thjeshta në pajisjet hardware sipas procedurave;
- Respekton masat mbrojtëse kundër elektriciteti statik gjatë punës me pajisjet hardware;
- Kryen zëvendësimin e komponentëve të dëmtuar të pajisjeve kompjuterike, sipas udhëzimeve;
- Kryen testimin e pajisjeve pas riparimit/zëvendësimit, sipas procedurës;
- Kryen dokumentimin dhe raportimin e mirëmbajtjes/riparimit të kryer, sipas formateve dhe hierarkisë.

NjN-19-II-0329-25 Instalimi dhe mirëmbajtja e programeve (software-ve)

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë programet aplikative sipas llojit dhe përdorimit të tyre;
2. Të përshkruajë rëndësinë e interpretimit logjik të manualeve;
3. Të përshkruajë teknikat e instalimit të sistemeve të shfrytëzimit dhe software-ve;
4. Të klasifikojë llojet e problematikave gjatë instalimit të sistemeve të shfrytëzimit dhe software-ve;
5. Të listojë mënyrat e përditësimeve të sistemeve të shfrytëzimit dhe programeve aplikative;
6. Të përshkruajë teknikat e ekzekutimit të komandave dhe skripteve të thjeshta;
7. Të listojë llojet e licencave dhe certifikatave të sigurisë;
8. Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të problemit dhe dokumentimit të tij;
9. Të përshkruajë rëndësinë e analizimit të historikut të ngjarjeve (log-eve);
10. Të listojë platformat e rrjeteve sociale dhe përdorimit të tyre;
11. Të përshkruajë teknikat e përditësimit të informacionit në website;
12. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të afateve të përditësimit (update), back up, restore dhe teknikat përkatëse;
13. Të përshkruajë rëndësinë e zgjidhjes së përkohshme të problemit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë instalimin dhe konfigurimin e software-ve;
2. Të kryejë mirëmbajtjen dhe përditësimin e software-ve;
3. Të ofrojë mbështetje teknike për përditësimin e platformave multimediale.

Kriteret e vlerësimit

- Organizon punën pas aprovimit për instalimet që do të kryhen;
- Përdor programet aplikative në përputhje me llojin dhe funksionalitetin e tyre;
- Kryen instalimin dhe konfigurimin e sistemeve të shfrytëzimit sipas udhëzimeve, duke përdorur metoda të ndryshme;
- Kryen instalimin dhe konfigurimin e programeve për përdoruesit sipas udhëzimeve duke përdorur metoda të ndryshme;
- Kryen saktë modifikime dhe ekzekutime të skripteve të thjeshta;
- Aplikon mënyra efektive të përditësimit të sistemeve të shfrytëzimit dhe programeve aplikative sipas praktikave më të mira;
- Përditëson platformat e rrjeteve sociale me publikime të reja;
- Zbaton teknikat e përditësimit të informacionit në website duke ndjekur praktikat më të mira të menaxhimit të përmbajtjes;
- Respekton afatet e përditësimit (update), backup dhe restore duke zbatuar teknikat përkatëse të sigurisë;
- Zbaton udhëzimet për zgjidhjen e përkohshme të problemeve për të siguruar vazhdueshmërinë e punës.

NjN-19-II-0330-25 Mbështetja e përdoruesit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mënyrat e diagnostikimit të problemeve teknike;
2. Të klasifikojë problemet sipas natyrës së tyre (hardware, software, rrjet, akses përdoruesi, etj.);
3. Të përshkruajë mënyrat e zgjidhjes së problemeve teknike të përdoruesve fundorë;
4. Të dallojë shkaqet e problemeve teknike;
5. Të përshkruajë rëndësinë e informimit nga përdoruesit për problematikat;
6. Të listojë platformat e komunikimit për asistencë teknike (telefon, e-mail, chat, Help Desk);
7. Të listojë mjetet e komunikimit në distancë për diagnostikim (Remote Desktop, TeamViewer, AnyDesk);
8. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të sistemit të menaxhimit të kërkesave;
9. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të Inteligjencës Artificiale (IA);
10. Të përshkruajë rëndësinë e udhëzimeve për përdoruesit fundorë;
11. Të përshkruajë hapat e referimit të problemeve në nivele më të larta të mbështetjes teknike;
12. Të shpjegojë procedurat për mbylljen e kërkesave të përdoruesve fundorë.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të udhëzojë përdoruesin për zgjidhjen e problemeve;
2. Të kryejë zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknike.

Kriteret e vlerësimit

- Merr informacion të saktë nga përdoruesit për problematikat;
- Udhëzon hap pas hapi për zgjidhjen e problemeve;
- Adreson në kohë problemin te personat përgjegjës;
- Mbështet përdoruesit për përdorimin e mjeteve të IA për diagnostikimin e problemeve;
- Mbështet përdoruesit në distancë duke dhënë udhëzimet e nevojshme;
- Kryen në kohë zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknike.

NjN-19-II-0331-25 Siguria e të dhënave

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të kuadrit ligjor për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave dhe rregullores së brendshme të sigurisë kibernetike dhe përputhshmërisë (Cybersecurity and GRC);
2. Të përshkruajë teknika të thjeshta të konfigurimit në funksion të sigurisë së rrjetit (Network Security);
3. Të përshkruajë llojet e pajisjeve që përdoren në funksion të sigurisë kibernetike;
4. Të përshkruajë llojet e programeve aplikative për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave;
5. Të përshkruajë teknikat dhe mjetet e kriptimit të thjeshtë të të dhënave;
6. Të listojë certifikimet e sigurisë së të dhënave në sistemet e TIK;
7. Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së masave që sigurojnë integritetin e të dhënave;
8. Të listojë metodat dhe mjetet për kryerjen e testeve apo auditeve të thjeshta të brendshme;
9. Të përshkruajë procedurat e asgjësimit të të dhënave dhe/ose pajisjeve, si dhe programeve të ruajtjes së të dhënave;
10. Të përshkruajë rëndësinë e konfigurimit/kontrollit të aksesit dhe attributeve të përdoruesve;
11. Të dallojë mënyrat e garantimit të disponueshmërisë së të dhënave;
12. Të përshkruajë rëndësinë e monitorimit, identifikimit dhe reagimit ndaj qasjeve potencialisht të rrezikshme;
13. Të përshkruajë mënyrat e udhëzimit të përdoruesve në funksion të rritjes së sigurisë së të dhënave.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë kuadrin ligjor dhe rregulloren e brendshme të sigurisë kibernetike dhe përputhshmërisë (Cybersecurity and GRC);

2. Të kryejë monitorimin, identifikimin dhe reagimin ndaj qasjeve potencialisht të rrezikshme;
3. Të kryejë instalime dhe konfigurime të thjeshta të infrastrukturës TIK në funksion të sigurisë së të dhënave.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon mjedisin e punës së përdoruesit sipas rregullores;
- Evidenton saktë burimet e sigurta të të dhënave;
- Transferon të dhënat në një mjedis tjetër në mënyrë të sigurt;
- Kontrollon periodikisht historikun e njoftimeve nga antivirusi;
- Përditëson antivirusin sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Kryen enkriptime/dekriptime të thjeshta sipas kërkesave të procesit të punës dhe rregullores;
- Konfiguron saktë parametrat e thjeshta në sistemin e shfrytëzimit;
- Asgjëson pajisjet e ruajtjes së të dhënave sipas rregullores;
- Respekton kuadrin ligjor dhe rregulloren e brendshme të sigurisë kibernetike dhe përputhshmërisë (Cybersecurity and GRC);
- Përdor teknika të thjeshta të konfigurimit në funksion të sigurisë së rrjetit (Network Security);
- Instalon certifikatat e sigurisë së të dhënave sipas udhëzimeve;
- Kryen monitorimin, identifikimin dhe reagimin ndaj qasjeve potencialisht të rrezikshme;
- Udhëzon saktë përdoruesit në funksion të rritjes së sigurisë së të dhënave.

NjN-19-II-0332-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për sigurimin teknik;
2. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të identifikojë teknikat e sigurta gjatë instalimeve;
4. Të listojë hapat bazë të ndihmës së parë në rast aksidenti;
5. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të sinjalistikës në mjedisin e punës;
6. Të rendisë hapat për evakuimin;
7. Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes nga zjarri;
8. Të listojë masat e sigurisë gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
9. Të dallojë saktë llojet e mbetjeve për ndarjen e tyre;
10. Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve;
11. Të përshkruajë procedurat për depozitimin e mbetjeve sipas rregullores së mjedisit;
12. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit racional të energjisë dhe materialeve për një zhvillim të qëndrueshëm;
13. Të përshkruajë protokollet e ndjekura në rast të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të respektojë standardet dhe legjislacionin shqiptar në fuqi lidhur me rregullat e sigurimit teknik;
2. Të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe të evakuimit në raste emergjente;
3. Të demonstrojë zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Kriteret e vlerësimit

- Respekton legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik;
- Zbaton manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në lidhje me sigurinë teknike;
- Zbaton teknika të sigurta gjatë instalimeve;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Respekton sinjalistikën në mjediset e punës;
- Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- Zbaton rregullat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Zbaton procedurat për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Ruan dhe magazinon materialet sipas procedurave për mbrojtjen e mjedisit;
- Depoziton mbetjet nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Përdor në mënyrë racionale energjinë dhe materialet, si dhe zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Zbaton protokollet në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	9	NjN-19-II-0325-25
2	Instalimi i pajisjeve hardware	12	NjN-19-II-0326-25
3	Instalimet e rrejtit	15	NjN-19-II-0327-25
4	Mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të pajisjeve hardware	15	NjN-19-II-0328-25
5	Instalimi dhe mirëmbajtja e programeve (software-ve)	15	NjN-19-II-0329-25
6	Mbështetja e përdoruesit	12	NjN-19-II-0330-25
7	Siguria e të dhënave	15	NjN-19-II-0331-25
8	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	7	NjN-19-II-0332-25
	Total	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësi të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **T-II-25**

T – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

II – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-19-II-0325-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

19 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

II – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK -së

0325 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit